

VENDIM
Nr. 741, datë 14.12.2023

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 389, DATË 12.6.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E LËSHIMIT TË PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE DHE TË SHËRBIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8668, datë 23.11.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shteti”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 389, datë 12.6.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas pikës 44 shtohen pikat 45, 46 e 47, me këtë përmbajtje:

“45. Sekretari i përgjithshëm i Federatës Shqiptare të Futbollit, pjesëmarrës në Kampionatin Evropian të Futbollit Euro 2024;

46. Trajneri, ndihmëstrajnerët, trajneri i portierëve dhe menaxheri i ekipit kombëtar të futbollit, të angazhuar për ndeshjet kualifikuese në Kampionatin Evropian të Futbollit Euro 2024;

47. Futbollistët e grumbulluar në ekipin kombëtar të futbollit për ndeshjet kualifikuese në Kampionatin Evropian të Futbollit Euro 2024.”.

2. Ngarkohen Ministria për Evropën për Punët e Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama